



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenin 78 paragrafi 1 i Statutit të Komunës me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01.nr.016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim Nr.11-114/11 të datës 29.11.2022 për lejin e participimit të pjesëm të pagesës së riparimit të automjetit të NJPZSH të pranuar si donacion , merre këtë:

VENDIM

1. Lejohet participimi i pjesëm të faturës Rechnung Nr.22RE-0490 të datës 15.08.2022 në emër të Shoqatës Konvoi der Hoffnung nga Gjermania për riparimin e Automjetit me shkallë hidraulike të NJPZSH në Gjiçan të pranuar si donacion nga vëllezërit Orana në shumë prej 3,490 € (tremijekatërqindentëdhjetëeuro).
- 2.Mjetet financiare nga pika 1 e këtij vendimi do të paguhet nga kodi buxhetor Mallra dhe Shërbime i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, përmes bartjes në xhirollogarinë rrjedhëse të "Rotary Club", [redacted] si bashkëpjesëmarrëse në mbulimin e një pjese të faturës për riparim e kamionit të cekur më sipër.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë; Kërkesa e DMSH Nr.11-114/11 të datës 29.11.2022 për lejin e participimit të pjesëm të riparimit të automjetit të NJPZSH të pranuar si donacion, Memorandumi i bashkëpunimit me "Rotary Club" Gjiçan nr.02/955 i datës 09.09.2022 dhe Fatura Rechnung Nr.22RE-0490 të datës 15.08.2022 e Shoqatës Konvoi der Hoffnung nga Gjermania.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit.

Vendimi ti dorëzohet;

- DMSH
- DBF
- Arkivit

